

V E N D I M
Nr.303, datë 16.4.1996

**PËR ÇELJEN DHE FILLIMIN E PUNËS SË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT
TË PASURISË SË PALUAJTSHME NË DISA RRETHE**

Në mbështetje të neneve 56 dhe 57 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Kryeregjistruesit të Pasurisë së Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rrethet Tiranë, Kavajë, Lushnjë dhe Gramsh me qendër në këto qytete çelet dhe fillon punën zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Ministria e Drejtësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurisë së Paluajtshme të marrin masat për transportimin, sistemimin dhe sigurimin e regjistrave të zyrave të hipotekës së këtyre rretheve pranë gjykatave të shkallës së parë, për të mbajtur të paprekura vlerat provuese e historike të tyre.

3. Personeli i hipotekave të këtyre rretheve do të kalojë brenda strukturës administrative të zyrave të regjistrimit me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Kryeregjistruesit të Pasurisë së Paluajtshme.

4. Nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për çeljen dhe funksionimin e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat do të hapen gjatë vitit 1996, jepen 20 milionë lekë për Kryeregjistruesin e Pasurisë së Paluajtshme: 13.4 milionë lekë për shpenzime operative dhe 6.6 milionë lekë për investime.

5. Për vitin 1996, të ardhurat që sigurohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve për shërbimet ose veprimtaritë që ato u ofrojnë të tretëve, 70 për qind përdoren nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe 30 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurisë së Paluajtshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi